

# TREGU I PUNËS

## LABOUR MARKET

2018







# TREGU I PUNËS

LABOUR MARKET

2018

## TREGU I PUNËS 2018

### Labour Market 2018

Drejtor botimi/Director of the Publication: **Delina Ibrahimaj**

Punoi/Prepared:

Ledia Thomo

Elda Muça

Julinda Haçkaj

Ornela Fitezi

© Copyright INSTAT 2019

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by any means without the prior written permission of the copyright holder.

Përpunimi në kompjuter / Computer processing:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta,

Ndërtesa 35, Hyrja 1

Tiranë, Kodi Postar 1017

Tel: + 355 4 2222411 / 2233356

Fax: +355 4 2222 411

e-mail: [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

## PËRMBAJTJA

### CONTENT

|                                                                                                                                                                                         |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>I. Karakteristika të përgjithshme të tregut të punës në Shqipëri, 2018</b><br><i>General characteristics of the Labour Market in Albania, 2018</i>                                   | <b>8</b>  |
| <b>II. Lista e tabelave</b><br><i>List of tables</i>                                                                                                                                    |           |
| <b>Tab 1.1: Forca e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Labour force by education, age and sex</i>                                                                        | <b>26</b> |
| <b>Tab 1.2: Punësimi sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Employment by education, age and sex</i>                                                                               | <b>27</b> |
| <b>Tab 1.3: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Labour force participation rate by education, age and sex</i>                          | <b>28</b> |
| <b>Tab 1.4: Shkalla e punësimit sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Employment rate by education, age and sex</i>                                                               | <b>29</b> |
| <b>Tab 1.5: Përqindja e të punësuarve me pagë në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Share of employees in total employment by education, age and sex</i>    | <b>30</b> |
| <b>Tab 1.6: Përqindja e të vetë-punësuarve në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Share of self-employment in total employment by education, age and sex</i> | <b>31</b> |

**Tab 1.7: Përqindja e të punësuarve si punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë** **32**

*Share of contributing family workers in total employment by education, age and sex*

**Tab 1.8 Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik (sipas NVE Rev.2)** **33**

*Employment structure by sex and economic activity (according to NACE Rev.2)*

**Tab 1.9: Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe profesionit (sipas ISCO-08)** **34**

*Employment structure by sex and occupation (according to ISCO-08)*

**Tab 1.10: Punësimi sipas gjinisë dhe orëve aktuale të punës në javë** **35**

*Employment by sex and weekly hours actually worked*

**Tab 1.11: Orët mesatare aktuale javore të punës sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik** **36**

*Mean weekly hours actually worked per employed person by sex and economic activity*

**Tab 1.12: Orët mesatare aktuale javore të punës për të punësuarit me pagë sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik** **37**

*Mean weekly hours actually worked per employee by sex and economic activity*

**Tab 1.13: Përqindja e të punësuarve me pagë me kontratë të përkohshme ndaj të punësuarve me pagë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë** **38**

*Share of temporary employees to total employees by education, age and sex*

|                                                                                                                                                                                                                     |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Tab 1.14: Përqindja e të punësuarve me kohë të pjesëshme ndaj të punësuarve gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Share of part time employment to total employment by education, age and sex</i> | <b>39</b> |
| <b>Tab 1.15: Popullsia në moshë pune sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Working age population by education, age and sex</i>                                                                               | <b>40</b> |
| <b>Tab 1.16: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Economically inactive population by education, age and sex</i>                                                            | <b>41</b> |
| <b>Tab 2.1: Papunësia sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Unemployment by education, age and sex</i>                                                                                                        | <b>42</b> |
| <b>Tab 2.2: Shkalla e papunësisë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Unemployment rate by education, age and sex</i>                                                                                        | <b>43</b> |
| <b>Tab 2.3: Papunësia afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Long term unemployment by education, age and sex</i>                                                                                    | <b>44</b> |
| <b>Tab 2.4: Shkalla e papunësisë afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Long term unemployment rate by education, age and sex</i>                                                                    | <b>45</b> |
| <b>Tab 2.5: Përqindja e të papunëve afatgjatë në papunësinë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë</b><br><i>Share of long term unemployed to unemployment by education, age and sex</i>                        | <b>46</b> |
| <b>Tab 3.1: Forca e punës sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Labour Force by prefectures and sex</i>                                                                                                               | <b>47</b> |

|                                                                                                                                                                                                  |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Tab 3.2: Punësimi sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Employment by prefectures and sex</i>                                                                                                   | <b>48</b> |
| <b>Tab 3.3: Punësimi sipas qarqeve dhe sektorëve kryesorë të ekonomisë</b><br><i>Employment by prefectures and main economic activities</i>                                                      | <b>49</b> |
| <b>Tab 3.4: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Labour Force participation rate by prefectures and sex</i>                                              | <b>50</b> |
| <b>Tab 3.5: Shkalla e punësimit sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Employment rate by prefectures and sex</i>                                                                                   | <b>51</b> |
| <b>Tab 3.6: Popullsia në moshë pune sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Working age population by prefectures and sex</i>                                                                        | <b>52</b> |
| <b>Tab 3.7: Papunësia sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Unemployment by prefectures and sex</i>                                                                                                | <b>53</b> |
| <b>Tab 3.8: Shkalla e papunësisë sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Unemployment rate by prefectures and sex</i>                                                                                | <b>54</b> |
| <b>Tab 3.9: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas qarqeve dhe gjinisë</b><br><i>Economically inactive population by prefectures and sex</i>                                                     | <b>55</b> |
| <b>Tab 4.1: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë</b><br><i>Gross average monthly wage per employee by economic activities and sex</i> | <b>56</b> |
| <b>Tab 4.2: Hendeku gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike</b><br><i>Gender pay gap by economic activity</i>                                                                                | <b>57</b> |



|                                                                                                                                                                                                                           |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Tab 4.3: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas group-profesioneve dhe gjinisë</b><br><i>Gross average monthly wage per employee by group of occupations and sex</i>                             | <b>58</b> |
| <b>Tab 4.4: Hendeku gjinor në paga sipas group-profesioneve</b><br><i>Gender pay gap by group of occupations</i>                                                                                                          | <b>59</b> |
| <b>Tab 4.5: Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto dhe gjinisë</b><br><i>Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals and sex</i> | <b>60</b> |
| <b>III. Shënime metodologjike</b><br><i>Methodological note</i>                                                                                                                                                           | <b>61</b> |
| <b>Tab A1: Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes</b><br><i>Generalised sampling standard deviations</i>                                                                                                        | <b>63</b> |
| <b>Tab A2: Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës</b><br><i>Generalised sampling standard deviations for the main labour market indicators</i>                        | <b>64</b> |

## KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË TREGUT TË PUNËS NË SHQIPËRI, 2018

Statistikat e tregut të punës në Shqipëri bazohen në dy burime kryesore, anketat dhe të dhënat administrative. Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vërtetim statistikor i vazhdueshëm i cili mbledh informacion cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të gjithë individët 15 vjeç e lart në Shqipëri. AFP mundëson marrjen e vlerësimeve për një gamë të gjerë treguesish të ofertës për punë të disagreguar sipas gjinisë dhe arsimit, dhe përdoret gjerësisht për hartimin e politikave dhe strategjive të punësimit në nivel kombëtar dhe për grupe specifike të popullsisë. Në këtë publikim, përveç të dhënave të vlerësuara sipas AFP, janë përfshirë dhe tregues me bazë burimet administrative që lidhen me pagën mesatare mujore bruto disagreguar sipas gjinisë, grup-aktiviteteve ekonomike dhe grup-profesioneve.

Gjatë vitit 2018 sipas vlerësimeve të marra nga Anketa e Forcave të Punës:

- Forca e punës është 1.404 mijë persona. Burrat përbëjnë 56,3 % të forcës së punës dhe gratë 43,7 %.
- Të punësuar janë 1.230 mijë persona, ku burrat përbëjnë 56,1 % të të punësuarve dhe gratë 43,9 %.
- Të papunë janë 173 mijë persona, ndër të cilët 57,7 % janë burra dhe 42,3 % janë gra.
- Shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshën 15-74 vjeç është 12,3 %. Për burrat shkalla e papunësisë është 0,8 pikë përqindje më e lartë sesa për gratë.
- Nga viti 2017 në vitin 2018 punësimi është rritur me 3,0 %, ndërsa shkalla zyrtare e papunësisë (për grup-moshën 15-74 vjeç) është ulur me 1,4 pikë përqindje.

## GENERAL CHARACTERISTICS OF THE LABOUR MARKET IN ALBANIA, 2018

Labour market statistics in Albania are based on two main sources, surveys and administrative data. The Labour Force Survey (LFS) is a continuous statistical survey that collects qualitative and quantitative information to assess key labour market indicators for all individuals aged 15 years and over in Albania. LFS enables estimations for a wide range of gender and education disaggregated indicators of job supply, and is widely used to develop policies and employment strategies at national level and for specific population groups. This publication includes the data evaluated about labour market based on LFS, and indicators based on administrative sources related to the average monthly gross wage disaggregated by gender, groups of economic activities and occupations.

Over the year 2018, according to Labour Force Survey estimates:

- Labour force is 1,404 thousand persons. Men account for 56.3 % of the labour force and women for 43.7 %.
- Employment is 1,230 thousand persons, from which men account for 56.1 % and women for 43.9 %.
- There were 173 thousand unemployed; 57.7 % of those are men and 42.3 % are women.
- The official unemployment rate for the age-group 15-74 years old is 12.3 %. The unemployment rate is 0.8 percentage points higher for men than women.
- From 2017 to 2018 employment has increased by 3.0 % and the official unemployment rate (15-74 years old) has decreased by 1.4 percentage points.

Ekonomikisht aktivë/  
Economically active persons

1.395.801



2018

Popullsia  
15-74 vjeç  
2.203.743

Ekonomikisht joaktivë/  
Economically inactive persons

807.943



Të punësuar/  
Employed persons

1.222.594



261.661

Punëtorë pa pagesë  
në biznesin familjar/  
Family Workers



413.985

Të vetëpunësuar/  
Self-employed



546.948

Të punësuar me pagë /  
Employees

Të papunë/  
Unemployed persons

173.207



Fig. 1 Shpërndarja e popullsisë 15-64 vjeç sipas statusit të aktivitetit ekonomik dhe gjinisë, 2018

*Distribution of population aged 15-64 years old by economic activity status and sex, 2018*





Fig. 2 Shpërndarja e popullsisë 15-64 vjeç sipas statusit të aktivitetit ekonomik, 2017-2018

*Distribution of population aged 15-64 years old by economic activity status, 2017-2018*



- 59,5 % e popullsisë 15-64 vjeç<sup>1</sup> është e punësuar, 8,7 % është e papunë dhe 31,7 % është ekonomikisht jo aktive (jashtë forcave të punës).
- 66,7 % e burrave 15-64 vjeç janë të punësuar, 10,1 % janë të papunë dhe 23,1 % janë jashtë forcave të punës.
- 52,4 % e grave 15-64 vjeç janë të punësuar, 7,4 % janë të papuna dhe 40,3 % janë jashtë forcave të punës.
- Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 50.589 lekë.
- Krahasuar me vitin 2017, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,3 %.
- Hendeku gjinor në paga është 10,7 %. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,7 % më të lartë sesa gratë.
- Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2018 vihet re një rritje e lehtë e hendekut gjinor në paga me 0,2 pikë përqindje.
- Gjatë vitit 2018, 26,6 % e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë kanë një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.
- 59.5 % of the population aged 15-64 years old<sup>1</sup> is employed, 8.7 % is unemployed and 31.7 % is economically inactive (outside the labour force).
- 66.7 % of men population aged 15-64 years old are employed, 10.1 % are unemployed and 23.1 % are outside the labour force.
- 52.4 % of women population aged 15-64 years old are employed, 7.4 % are unemployed and 40.3 % are outside the labour force.
- The average monthly gross wage for an employee in Albania is 50,589 ALL.
- Compared to 2017, the average monthly gross wage for an employee in Albania increased by 3.3 %.
- The gender pay gap is 10.7 %. So men have a gross monthly average wage of 10.7 % higher than women.
- Compared to the previous year, in 2018 there is a slight increase of the gender pay gap by 0.2 percentage points.
- During 2018, 26.6 % of the contributors on the category of employees have an average monthly gross wage up to the official minimum wage level.

1. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

1. The labour force participation and employment rates are calculated based on the population aged 15 to 64 years. The unemployment rate is calculated based on the economically active population (labour force) aged 15 and over. The employment and labour force participation rates calculated for those aged 15 and over are affected by the inclusion of the retired population in the denominator and are therefore less meaningful than the rates calculated for those aged from 15 to 64. However, for calculating the unemployment rate for those aged 15 and over, the denominator is the economically active population which includes people in work or actively seeking and ready to work. Therefore, this indicator is not affected by the population over the retirement age.

## PUNËSIMI

Gjatë vitit 2018, numri i të punësuarve në Shqipëri është 1.230 mijë persona. Krahasuar me vitin pararendës punësimi u rrit me 3,0 %.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 68,3 %. Për burrat e moshës 15-64 vjeç shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 17,2 pikë përqindje më e lartë sesa për gratë.

Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,5 %. Shkalla e punësimit për gratë është 52,4 % dhe për burrat 66,7 %. Hendeku gjinor në punësim për këtë grup-moshë është 14,3 pikë përqindje.

Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 42,9 % dhe 37,4 % të të punësuarve gjithsej.

Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve reflekton strukturën e punësimit sipas sektorëve. Në vitin 2018, punonjësit e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit përbëjnë 47,7 % të të punësuarve. Nëpunësit dhe punonjësit e shitjeve dhe shërbimeve përbëjnë 19,4 % të të punësuarve.

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2018, rezulton se 44,5 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 34,0 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 21,6 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

Vlerësimet e marra nga AFP tregojnë se 28,7 % e gratë të punësuar dhe 15,9 % e burrave të punësuar janë punëtorë pa pagesë të familjes.

Në këndvështrimin gjinor, gratë kanë 1,8 herë më shumë gjasa sesa burrat për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

## Employment

Over the year 2018, the number of employed in Albania is 1,230 thousand persons. Compared to the previous year employment has increased by 3.0 %.

Labour force participation rate for the population aged 15-64 years old is 68.3 %. For men population aged 15-64, the labour force participation rate is 17.2 percentage points higher than women.


The employment rate for the population aged 15-64 years old is 59.5 %. The employment rate for women is 52.4 % and for men 66.7 %. The gender gap in employment for this age-group is 14.3 percentage points.

The service and agricultural sectors have the highest share of employed with respectively 42.9 % and 37.4 % of the total employment.

Analysis of employment by main occupation groups reflects the employment structure by sectors. In 2018, agricultural workers account for 47.7 % of total employment. Clerical, service and sales workers account for 19.4 % of employed.

According to the 2018 survey estimates, 44.5 % of employed are employees, 34.0 % are self-employed (with employees or without employees) and 21.6 % are contributing family workers.

LFS estimates show that 28.7 % of employed women and 15.9 % of employed men are contributing family workers. From a gender perspective, women are 1.8 times more likely than men to be contributing family workers.



**3,4** Të vetëpunësuar me të punësuar  
kundrejt një page/  
Self-employed with paid employees

**20,4** Punëtorë pa pagesë në  
biznesin familjar/  
Unpaid Family workers

**30,1** Të vetëpunësuar pa të punësuar  
kundrejt një page/  
Self-employed without paid  
employees

**46,1** Të punësuar me pagë/  
Employees




Fig. 3 Punësimi (15+) sipas aktiviteteve ekonomike, 2018

*Employment (15+) by economic activities, 2018*




Fig. 4 Punësimi (15+) sipas statusit në punësim, 2017-2018

*Employment (15+) by status in employment, 2017-2018*



Shpërndarja e të papunëve  
sipas nivelit arsimor

2018



Deri më 8/9 vjeçare  
/Primary education

34,5 %

Arsim të mesëm të  
përgjithshëm/Secondary  
education

32,1 %

Arsim të mesëm  
profesional/  
- Secondary Vocational  
Education

10,6 %

Universitet/  
Tertiary education

22,5 %

Doktoraturë/  
PHD

0,2 %

Të papunë/ Unemployed 15-74 100%



## PAPUNËSIA

Gjatë vitit 2018 numri i të papunëve në Shqipëri është 173.207 persona. Shkalla zyrtare e papunësisë është 12,3 % dhe u ul me 1,4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017. Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat është 12,7 % dhe për gratë është 11,9 %.

Shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 28,3 %. Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve pësoi një rënie prej 3,6 pikë përqindje.

Personat e papunë prej një viti a më shumë përbëjnë 67,4 % të të papunëve gjithsej. Krahasuar me vitin e mëparshëm, pesha që zënë të papunët afatgjatë në papunësinë gjithsej është rritur me 2,6 pikë përqindje.

Duke analizuar shkallën e papunësisë sipas nivelit arsimor në vitin 2018, në tregun e punës në Shqipëri vihet re që shkalla e papunësisë është më e lartë për personat me arsim të mesëm, 14,3 % ndjekur nga ata me arsim të lartë, 14,0 %.

Gjatë vitit 2018, krahasuar me vitin e mëparshëm, pati një rënie të shkallës së papunësisë për personat me arsim 8/9 vjeçar me 2,4 pikë përqindje dhe për personat me arsim të mesëm me 1,2 pikë përqindje. Ndërsa për personat me arsim të lartë, pati një rritje të shkallës së papunësisë me 0,3 pikë përqindje.

## Unemployment

Over the year 2018, the number of unemployed in Albania is 173,207 persons. The official unemployment rate is 12.3 %, decreasing by 1.4 percentage points compared to 2017. The official unemployment rate for men is 12.7 % and for women is 11.9 %.

Youth (15-24 years old) unemployment rate is 28.3 %. Compared to the previous year, youth unemployment rate has decreased by 3.6 percentage points.

Unemployed persons from one year or more account for 67.4 % of all unemployed. Compared to the previous year, the share of long term unemployed to the total unemployment has increased by 2.6 percentage points.

Analysis of the unemployment rate by educational level shows that in Albanian labour market in 2018 the unemployment rate is higher among persons with upper secondary education, 14.3 % followed by those with tertiary education, 14.0 %.

Over the year 2018, the unemployment rate decreased among persons with 8/9 years school education by 2.4 percentage points and for persons with upper secondary education by 1.2 percentage points compared to the previous year. Whereas for persons with tertiary education, the unemployment rate increased by 0.3 percentage points.




Fig. 5 Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave, 2017-2018

*Unemployment rate by age groups, 2017-2018*




Fig. 6 Shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor (popullsia 15+), 2017-2018

*Unemployment rate by educational level (population 15+), 2017-2018*

## POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE (JASHTË FORCAVE TË PUNËS)

Gjatë vitit 2018, 31,7 % e popullsisë 15-64 vjeç është ekonomikisht jo-aktive. Struktura e popullsisë jashtë forcave të punës është e dominuar nga nxënësit/studentët, 38,7 %.

Në këtë grup-moshë, pjesa që zënë personat e papunë të cilët nuk po kërkojnë punë për arsye se besojnë se nuk ka punë të disponueshme është 8,7 %.

Ndër popullsinë e grave të moshës 15-64 vjeç ekonomikisht jo aktive 30,8 % e tyre janë duke përmbushur detyrat shtëpiake ndërsa tek burrat e kësaj kategorie kjo përqindje është 1,6 %.

### **Të rinjtë jo në punësim e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë trajnim**

Në vitin 2018, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç as në punësim e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 28,6 % të të rinjve gjithsej. Në këtë grup, 36,6 % e të rinjve janë të papunë. Pjesa tjetër janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (11,7 %), duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (22,0 %) ose për arsye të tjera (29,6 %).

Ndër të rinjtë që janë as të punësuar as në shkollë apo trajnim profesional sipas gjinisë dhe statusit të tyre në tregun e punës, burrat janë më aktivë në treg sesa gratë (50,4 % e burrave janë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për të punuar, ndërsa tek gratë kjo përqindje është 25,7 %).

## Economically inactive population (outside the labour market)

Over the year 2018, 31.7 % of the population aged 15-64 years old is economically inactive. The structure of the population outside labour market is dominated by pupils/students, 38.7 %.

In this age-group, 8.7 % are not looking for a job because they believe that there are not available jobs.

Among the economically inactive women population aged 15-64 years old, 30.8 % of them are fulfilling domestic tasks while the respective percentage of men is 1.6 %.

### **Youth neither in employment nor in education or training**

Over the year 2018, youth aged 15-29 years old neither in employment nor in education or training account for 28.6 % of all youth population. In this group, 36.6 % are unemployed. The other part is outside the labour force because they are discouraged workers, 11.7 % or fulfilling domestic and family responsibilities, 22.0 % or for other reasons, 29.6 %.

Among youth who are neither in employment nor in education or training by sex and their status in the labour market, men are more active than women (50.4 % of men are seeking for a job and are available to work, while for women this percentage is 25.7 %).




Fig. 7 Struktura e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht jo aktive sipas gjinisë, 2018

*Structure of the economically inactive population aged 15-64 years old by sex, 2018*




Fig. 8 Të rinjtë (15-29 vjeç) jo në punësim dhe as duke ndjekur shkollën, sipas statusit në tregun e punës, 2018

*Youth (15-29) neither in employment nor in education, by labour market status, 2018*

## TREGUES SIPAS QARQEVE

Në vitin 2018, qarqet me shkallë punësimi më të lartë janë: Elbasan, 61,5 % dhe Korçë, 59,5 % ndërsa qarku me shkallë punësimi më të ulët është qarku Lezhë, 45,6 %.

Qarqet me shkallë papunësie më të lartë janë qarku i Vlorës me 21,9 % dhe qarku i Lezhës me 19,2 %.


Në vitin 2018, në qarkun e Tiranës, shërbimet punësojnë pjesën më të madhe të të punësuarve gjithsej, 66,5 % të tyre. Në këtë qark 26,6 % e të punësuarve gjithsej janë të punësuar në sektorin e industrisë dhe vetëm 6,9 % e tyre punojnë në bujqësi. Qarku i Durrësit ka rreth 52,2 % të të punësuarve të angazhuar në sektorin e shërbimeve, 34,2 % në sektorin e industrisë dhe 13,6 % në sektorin e bujqësisë. Në qarkun e Vlorës dhe Lezhës rreth 44,0 % e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve, respektivisht 23,4 % dhe 21,6 % në sektorin e industrisë dhe 32,6 % dhe 35,0 % në sektorin e bujqësisë. Në qarqet e tjera të vendit është punësimi në bujqësi ai që zë një peshë të konsiderueshme me mbi 40,0 %.

## Indicators by prefectures

Over 2018, prefectures with the highest employment rate are: Elbasan, 61.5 % and Korçë, 59.5 %, whereas the prefecture with the lowest employment rate is Lezhë, 45.6 %. Prefectures with the highest unemployment rate are those of Vlorë, 21.9 % and Lezhë, 19.2 %.

In the prefecture of Tirana, services employ the major part of the total employed, 66.5 %. In this prefecture, 26.6 % of the total employed are in industry while only 6.9 % of them are engaged in agriculture activities. The prefecture of Durrës has 52.2 % of employed engaged in services, 34.2 % in industry and 13.6 % in agriculture. In prefectures of Vlorë and Lezhë around 44 % of employed work in services sector; respectively 23.4 % and 21.6 % in industry; and 32.6 % and 35.0 % in agriculture. In other prefectures of the country, it is the employment in agriculture that prevails with more than 40.0 % of the total employment.

Treguesit vjetor sipas  
qarqeve  
2018



Qarqet me shkallë  
punësimi më të lartë/  
Prefectures with higher  
employment rate

**Elbasan 67,6**  
**Korçë 67,0**



Qarqet me shkallë  
punësimi më të ulët/  
Prefectures with lower  
employment rate

**Lezhë 53,0**  
**Tiranë 53,6**



Qarqet me shkallë  
papunësie më të ulët/  
Prefectures with lower  
unemployment rate

**Dibër 5,9**  
**Korçë 5,9**



Qarqet me shkallë  
papunësie më të lartë/  
Prefectures with higher  
unemployment rate

**Vlorë 21,9**  
**Lezhë 19,2**





Fig. 9 Struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë, 2018

*Employment structure by prefectures and economic sectors, 2018*



Hendeku gjinor në pagë  
Gender pay gap

10,7 %



| Grup-profesionet sipas ISCO-08                                                  | 2018        | Occupation groups according to ISCO-08             |
|---------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------------------------------------------|
| <b>Gjithsej</b>                                                                 | <b>10,7</b> | <b>Total</b>                                       |
| Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë | 0,9         | Managers                                           |
| Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)                                   | 21,7        | Professionals                                      |
| Teknikë dhe specialistë në zbatim                                               | 12,8        | Technicians and Associate Professionals            |
| Nëpunësit                                                                       | -2,2        | Clerical Support Workers                           |
| Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve                                          | 21,4        | Services and Sales Workers                         |
| Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit                       | 7,8         | Skilled Agricultural, Forestry and Fishery Workers |
| Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to                               | 27,0        | Craft and Related Trades Workers                   |
| Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve                 | 27,4        | Plant and Machine Operators, and Assemblers        |
| Punëtorë (Profesione elementare)                                                | 8,2         | Elementary Occupations                             |
| Forcat e armatosura                                                             | 2,3         | Armed Forces Occupations                           |

## PAGAT

Në vitin 2018, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 50.589 lekë. Kjo pagë është llogaritur me të dhënat e listë-pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe mbulon të gjithë sektorët e ekonomisë dhe kontribuesit, shtetas shqiptarë e të huaj, për të cilët ndërmarrja deklaron pagë mujore bruto.

Krahasuar me vitin 2017, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,3 %. Hendeku gjinor në paga është 10,7 %. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,7 % më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2018 vihet re një rritje e hendekut gjinor në paga me 0,2 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2018, 26,6% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2018, paga minimale zyrtare është 24.000 lekë.

Paga mesatare mujore bruto është mbi nivelin mesatar për aktivitetet ekonomike si: Aktivitetet Financiare dhe të sigurimit; Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale. Ndërsa aktivitetet ekonomike me pagë poshtë nivelit mesatar janë: Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor; dhe Bujqësia, Silvikultura dhe Peshkimi.

Hendeku gjinor në paga është më i theksuar mes punonjësve që janë të punësuar në ndërmarrjet ekonomike që i përkasin grup-aktivitetit ekonomik "Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit".

## Wages

In 2018, in Albania, the average monthly gross wage per employee is 50,589 ALL. This wage is calculated based on the enterprises' payrolls declared to the General Directorate of Taxation for contributions on social security, health and tax on income from employment. It covers all the sectors of economy and contributors, albanian and foreign citizens for whom the enterprise declares a gross monthly wage.

Compared to 2017, the average monthly gross wage per employee is increased by 3.3%. The gender pay gap is 10.7%. So men have average monthly gross wage of 10.7 % higher than women. In 2018, compared to the previous year, there is an increase of the gender pay gap by 0.2 percentage points.

During 2018, 26.6 % of employee receive an average monthly gross wage higher than official minimum wage. For the year 2018, the official minimum wage is 24,000 ALL.

The average monthly gross wage is above the average for economic activities such as: Financial and Insurance Activities; Public administration and defense; compulsory social security; education; human health and social work activities. While economic activities below the average level are: Wholesale and retail trade; repair of motor vehicles and motorcycles; transport and storage; accommodation and food service activities; and Agriculture, forestry and fishing.

The gender pay gap is higher among employees who are employed in economic enterprises belonging to the economic activity group "Mining and quarrying; manufacturing; electricity, gas, steam and air conditioning supply; water supply; sewerage, waste management and remediation activities". For this group-activity, the gender pay gap is 35.1 %. Compared with the previous year, the gender pay gap for this group of activities has decreased by 0.5 percentage points.

Për këtë grup-aktivite, hendeu gjinor në paga është 35,1 %. Krahëuar me vitin e mëparshëm hendeu gjinor në paga për këtë grup aktivitete ka rënë me 0,5 pikë përqindje.

Në vitin 2018, grup-profesionet më të paguara janë: Ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore dhe drejtorët ekzekutivë; Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); dhe teknikët dhe specialistët në zbatim. Ndërsa grup-profesionet me pagë nën nivelin mesatar janë: Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit; punëtorët e profesioneve elementare; dhe zejtarët, artizanët dhe profesione të lidhura me to.

In 2018, the most paid professions are: Lawmakers, senior civil servants and executive directors; Specialists with higher education (professionals); and technicians and specialists in implementation. Professions below the average level are: Qualified employees of forestry and fishing agriculture; workers of professional professions; and craftsmen, artisans and related professions.




Fig. 10 Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto, 2018

*Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals*

Tab.1.1

## Forca e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Labour force by education, age and sex

(numër - number)

| Niveli arsimor<br>Educational level   | Grup-mosha<br>Age-group | Gjithsej - Total |           | Burra - Men |         | Gra - Women |         |
|---------------------------------------|-------------------------|------------------|-----------|-------------|---------|-------------|---------|
|                                       |                         | 2017             | 2018      | 2017        | 2018    | 2017        | 2018    |
| Gjithsej<br>Total                     | Total (15 +)            | 1.385.395        | 1.404.059 | 794.946     | 790.661 | 590.449     | 613.398 |
|                                       | 15-64                   | 1.339.825        | 1.347.462 | 766.233     | 754.900 | 573.591     | 592.564 |
|                                       | 20-64                   | 1.309.346        | 1.316.415 | 745.867     | 733.804 | 563.479     | 582.612 |
|                                       | 15-24                   | 140.466          | 165.211   | 91.383      | 103.680 | 49.083      | 61.532  |
|                                       | 25-29                   | 156.059          | 183.328   | 92.317      | 104.072 | 63.743      | 79.254  |
|                                       | 25-54                   | 978.305          | 942.117   | 535.064     | 504.735 | 443.242     | 437.381 |
|                                       | 55-64                   | 221.053          | 240.134   | 139.786     | 146.486 | 81.267      | 93.650  |
|                                       | 65+                     | 45.571           | 56.597    | 28.713      | 35.762  | 16.858      | 20.835  |
| Arsim 8/9 vjeçar<br>Primary education | Total (15 +)            | 618.906          | 606.054   | 338.493     | 321.605 | 280.414     | 284.449 |
|                                       | 15-64                   | 583.836          | 561.600   | 318.350     | 296.310 | 265.487     | 265.290 |
|                                       | 20-64                   | 564.852          | 542.838   | 305.035     | 283.561 | 259.817     | 259.277 |
|                                       | 15-24                   | 47.390           | 49.881    | 34.540      | 32.443  | 12.850      | 17.439  |
|                                       | 25-29                   | 45.375           | 51.446    | 26.823      | 32.539  | 18.552      | 18.906  |
|                                       | 25-54                   | 431.581          | 398.907   | 226.461     | 204.534 | 205.120     | 194.373 |
|                                       | 55-64                   | 104.865          | 112.812   | 57.350      | 59.334  | 47.516      | 53.478  |
|                                       | 65+                     | 35.070           | 44.454    | 20.143      | 25.295  | 14.927      | 19.159  |
| Arsim të mesëm<br>Secondary education | Total (15 +)            | 503.083          | 517.385   | 331.589     | 344.814 | 171.493     | 172.571 |
|                                       | 15-64                   | 495.603          | 508.455   | 325.536     | 337.126 | 170.067     | 171.329 |
|                                       | 20-64                   | 484.489          | 496.192   | 318.667     | 328.779 | 165.821     | 167.413 |
|                                       | 15-24                   | 67.060           | 81.811    | 46.061      | 59.067  | 21.000      | 22.744  |
|                                       | 25-29                   | 46.950           | 55.864    | 36.760      | 41.718  | 10.190      | 14.144  |
|                                       | 25-54                   | 337.834          | 326.682   | 214.722     | 208.676 | 123.114     | 118.006 |
|                                       | 55-64                   | 90.708           | 99.961    | 64.754      | 69.383  | 25.954      | 30.579  |
|                                       | 65+                     | 7.480            | 8.930     | 6.053       | 7.688   | ...         | ...     |
| Arsim të lartë<br>Tertiary education  | Total (15 +)            | 263.406          | 280.621   | 124.864     | 124.242 | 138.543     | 156.378 |
|                                       | 15-64                   | 260.385          | 277.408   | 122.347     | 121.464 | 138.038     | 155.945 |
|                                       | 20-64                   | 260.005          | 277.385   | 122.164     | 121.464 | 137.842     | 155.922 |
|                                       | 15-24                   | 26.016           | 33.519    | 10.782      | 12.170  | 15.234      | 21.349  |
|                                       | 25-29                   | 63.735           | 76.018    | 28.733      | 29.815  | 35.001      | 46.203  |
|                                       | 25-54                   | 208.890          | 216.528   | 93.882      | 91.526  | 115.008     | 125.002 |
|                                       | 55-64                   | 25.480           | 27.361    | 17.684      | 17.769  | 7.796       | 9.593   |
|                                       | 65+                     | 3.022            | 3.213     | 2.517       | 2.780   | ...         | ...     |

... informacion i disponueshëm por jo i përdorshëm / information is available but unusable

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2017-2018

Source of information: Labour Force Survey, 2017-2018

Tab.1.2

## Punësimi sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Employment by education, age and sex

(numër - number)

| Niveli arsimor<br>Educational level   | Grup-mosha<br>Age-group | Gjithsej - Total |           | Burra - Men |         | Gra - Women |         |
|---------------------------------------|-------------------------|------------------|-----------|-------------|---------|-------------|---------|
|                                       |                         | 2017             | 2018      | 2017        | 2018    | 2017        | 2018    |
| Gjithsej<br>Total                     | Total (15 +)            | 1.194.969        | 1.230.852 | 678.798     | 690.637 | 516.170     | 540.215 |
|                                       | 15-64                   | 1.150.430        | 1.174.840 | 650.444     | 655.342 | 499.987     | 519.499 |
|                                       | 20-64                   | 1.131.220        | 1.153.422 | 637.906     | 641.985 | 493.314     | 511.437 |
|                                       | 15-24                   | 95.658           | 118.483   | 60.177      | 72.952  | 35.481      | 45.531  |
|                                       | 25-29                   | 124.092          | 149.515   | 73.849      | 86.722  | 50.242      | 62.793  |
|                                       | 25-54                   | 854.899          | 836.805   | 465.458     | 449.039 | 389.441     | 387.765 |
|                                       | 55-64                   | 199.874          | 219.553   | 124.809     | 133.351 | 75.065      | 86.202  |
|                                       | 65+                     | 44.538           | 56.012    | 28.355      | 35.295  | 16.184      | 20.717  |
| Arsim 8/9 vjeçar<br>Primary education | Total (15 +)            | 542.705          | 546.167   | 289.943     | 286.612 | 252.763     | 259.555 |
|                                       | 15-64                   | 508.382          | 502.112   | 269.948     | 261.645 | 238.434     | 240.467 |
|                                       | 20-64                   | 496.438          | 489.198   | 262.032     | 253.732 | 234.406     | 235.466 |
